

Trusti

FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS



BULETINI TREMUJOR
NR 69 -- VITI XVIII – TM1 2025

TRUSTORJA

PERFORMANCA – PORTOFOLI STANDARD

PERIUDHA	1 MUAJ	3 MUAJ	VITI AKTUAL	3 VJET	5 VJET	NGA THEMELIMI
REZULTATI	-3.44%	-1.57%	-1.57%	+7.07%	+24.62%	+79.47%
BENÇMARKU*	+0.83%	+1.91%	+1.91%	+12.73%	+25.54%	+75.28%

*Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit sikurse i publikuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës.

LËVIZJET MUJORE – TRE PORTOFOLAT

NDRYSHIMI I ÇMIMIT TË AKSIONIT				KTHIMI BRUTO STANDARD (MLN)	KTHIMI BRUTO BALANCUAR (MLN)	KTHIMI BRUTO KONSERVATIV (MLN)
MUAJI	STANDARD	BALANCUAR	KONSERVATIV			
Janar	+2.51%	+1.91%	+0.29%	€ 67.75	€ 7.31	€ 0.49
Shkurt	-0.59%	-0.31%	+0.26%	€ (14.61)	€ (1.10)	€ 0.44
Mars	-3.44%	-1.95%	+0.29%	€ (93.63)	€ (7.43)	€ 0.49
Tremujori	-1.57%	-0.39%	+0.84%	€ (40.49)	€ (1.22)	€ 1.42

KONTRIBUIMI

KONTRIBUTET E REJA STANDARD (MLN)		LLOGARI TË REJA	LLOGARI AKTIVE	LLOGARI GJITHSEJ **
Janar	€ 31.28	2,232	336,259	876,426
Shkurt	€ 27.70	2,551	336,009	878,977
Mars	€ 27.10	2,719	339,590	881,696
Tremujori	€ 86.08	7,502	337,286*	

*Mesatarja tremujore

**Kjo shifër i përfshin të gjitha llogaritë e hapura në FKPK nga themelimi e deri në datën e raportit.

PENSIONIMET

SHUMA E TËRHEQUR (Bruto)		TË PENSIONUAR	ARSYEJA E PENSIONIMIT			
			MOSHE	INVALIDITET	VDEKJE	TJERA
Janar	€6,787,385	699	533	94	70	2
Shkurt	€6,156,338	643	500	69	66	8
Mars	€7,269,739	790	634	89	67	0
Tremujori	€20,213,462	2,132	1,667	252	203	10

PËRMBLEDHJE SHIFRASH SIPAS TREMUJORËVE PËR VITIN 2025

	FUNDI TM1	FUNDI TM2	FUNDI TM3	FUNDI TM4
ÇMIMI I AKSIONIT STANDARD	€ 1.7947			
ÇMIMI I AKSIONIT BALANCUAR	€ 1.0364			
ÇMIMI I AKSIONIT KONSERVATIV	€ 2.2250			
KTHIMI BRUTO NGA INVESTIMET PËR TREMUJOR STANDARD (në milionë)	€ (40.49)			
KTHIMI BRUTO NGA INVESTIMET PËR TREMUJOR BALANCUAR (në milionë)	€ (1.22)			
KTHIMI BRUTO NGA INVESTIMET PËR TREMUJOR KONSERVATIV (në milionë)	€ 1.42			
MNM* STANDARD	€ 2,664,617,347			
MNM* BALANCUAR	€ 380,331,588			
MNM* KONSERVATIV	€ 159,512,722			
LLOGARI GJITHSEJ	881,696			
LLOGARI AKTIVE	339,590			
TARIFA INVESTUESE PËR TREMUJORIN**	€ 2,402,134			
TARIFA OPERACIONALE PËR TREMUJORIN**	€ 376,334			
INVESTIMET NË KOSOVË	€ 636,583,389			
INVESTIMET JASHTË	€ 2,570,573,162			

MNM* Mjetet Neto nën Menaxhim****** Përfshihen tarifat e tre portofolave: Standard - Balancuar - Konservativ

PLASMANET DHE PERFORMANCA NË FUND TË TM1 2025

MENAXHUESI FONDI INSTITUCIONI	NUMRI ISIN LLOJI INVESTIMIT	PLASMANET FUNDI I TM1 2025	KTHIMI BRUTO NË INVESTIME (PËR TREMUJORIN)
Vanguard GSIF	IE00B03HD316	€ 613,682,086.95	€ (17,334,333.37)
Amundi 3 MI	FR0007038138	€ 265,349,944.68	€ 2,550,915.75
Invesco S&P 500 UCITS	IE00BRKWGL70	€ 252,076,425.09	€ (16,306,153.02)
Nordea 1-SRF	LU0539147214	€ 181,617,024.25	€ 1,542,932.02
Nordea 1-GSEF	LU0257969260	€ 125,926,463.70	€ 3,449,966.39
iShares MSCI GM ETF	IE00BQN1K901	€ 102,107,793.60	€ 10,468,033.95
Schroder ISF Global Equity	LU0248167297	€ 96,790,760.36	€ (1,709,239.64)
iShares US Infrastructure	US46435U7138	€ 73,542,439.06	€ (5,378,081.57)
Invesco QQQ ETF	US46090E1038	€ 72,961,725.48	€ (6,933,115.96)
Vanguard Value ETF	US9229087443	€ 71,804,322.59	€ (2,562,362.46)
Global X US Infrastr.	US37954Y6730	€ 71,028,267.83	€ (8,642,168.86)
Schroder ISF Global	LU0776414590	€ 68,249,353.65	€ (250,646.35)
Schroders ISF	LU2802595350	€ 59,481,589.87	€ (2,033,357.05)
SPDR S&P Oil&Gas ETF	US78468R5569	€ 54,089,106.49	€ (3,123,825.18)
iShares R&M RE ETF	US4642885622	€ 48,410,206.47	€ 712,479.11
Amundi MSCI Japan	LU2133056387	€ 42,329,969.00	€ (450,325.94)
Amundi MSCI Europe	LU1681041890	€ 40,524,908.40	€ 1,613,348.98
SPDR MSCI Energy ETF	IE00BKWQ0F09	€ 33,909,716.50	€ 3,512,102.62
iShares Listed Private Equity	IE000D8FCSD8	€ 30,324,070.55	€ 353,683.16
Vanguard Eurozone ETF	IE00BH04GL39	€ 26,946,857.52	€ (352,118.78)
SPDR Russel 200 UCITS	IE00BJ38QD84	€ 26,878,436.50	€ (3,784,814.90)
WisdomTree WTI	GB00B15KXV33	€ 25,805,388.96	€ (867,748.74)
SPDR S&P DA ETF	IE00B5M1WJ87	€ 25,435,767.83	€ 2,462,704.89
Pacer Data&Infras. ETF	US69374H7411	€ 25,135,524.60	€ (1,734,680.93)
Future of Defence UCITS ETF	IE000OJ5TQP4	€ 15,559,251.84	€ (430,938.81)
VanEck Defense ETF A	IE000YYE6WK5	€ 15,486,854.71	€ (498,698.77)
Global X	US37954Y2366	€ 7,264,261.76	€ (444,113.80)
iShares US	US4642875318	€ 6,713,839.17	€ (972,000.90)
Thesari i Kosovës	Letra me vlerë të Kosovës	€ 520,834,360.66	€ 4,059,351.58
Banka në Kosovë	Depozita bankare	€ 153,537,213.84	€ 1,467,123.28
BQK - të gatshme	Të painvestuara	€ 51,744,839.50	€ 19,305.88
Erste Bank (Broker)	Të painvestuara	€ 1,421,780.02	€ 7,676.28
Të arkëtueshme	--	€ 186,000.45	--
Dividendat	--	--	€ 1,302,921.03
GJITHSEJ		€ 3,207,156,551.88	€ (40,286,180.11)

LAJME

ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE DHE NDIKIMI NË FKPK	11 prill 2025 - Për shkak të zhvillimeve të shpejta në tregjet financiare për tremujorit të parë 2025, Bordi Drejtues më 11 prill e ka publikuar deklaratën në vijim. Tregjet financiare globale janë përballur së fundmi me një valë paqëndrueshmërie, për shkak të tensioneve tregtare nga rritja e tarifave në tregtinë ndërkombëtare. Këto zhvillime kanë nxitur reaksion në tregjet globale të aksioneve pasi që tarifat mund të ndikojnë në rritje të konsiderueshme të inflacionit dhe si pasojë të shkaktojnë recesion global ekonomik. Që nga fillimi i vitit 2025 e deri në datën e raportimit, indekset e rëndësishme të bursave, si S&P 500 dhe NASDAQ, kanë shënuar rënie -10.2% dhe -15%, përkatësisht. Përkundër kësaj, efektet në portofolat e FKPK-së ishin më të kontrolluara, për shkak të strukturës së balancuar dhe strategjisë së diversifikimit që zbatohet në vazhdimësi. Në vijim shihet ndikimi i luhatjeve të tregjeve deri më datën 10 prill në 2025, në portofolat investues të FKPK-së. - Portofoli Konservativ (për kontribuuesit afër pensionimit 63+ vjeç): Nuk është i ekspozuar në tregje të huaja të aksioneve, andaj as nuk është i prekur, duke ofruar mbrojtje maksimale për kontributdhënësit para pensionimit. Kthimi për vitin aktualisht është +0.9%, ndërsa që nga themelimi i portofolit është +11.3%. Kjo dëshmon se të gjithë kontribuuesit që janë dy vjet, ose më afër pensionimit të moshës, nuk preken nga këto luhatje në tregjet financiare. - Portofoli i Balancuar (për kontribuuesit e moshës 58-62 vjeçare): Ka shfaqur rezistencë të lartë kundrejt tregut të përgjithshëm, duke e reflektuar mbrojtjen që ofron qasja e balancuar ndaj investimeve në këtë grupmoshë. Kthimi për vitin aktualisht është -3.9%. - Portofoli Standard (për kontribuuesit e moshës deri 57 vjeçare): Është ndikuar më dukshëm nga rëniet në tregjet e aksioneve, por mbetet në kuadër të pritshmërive (krahasuar me lëvizjet në tregjet financiare) për një portofol me horizont të gjatë investimi. Diversifikimi i aksioneve midis rajoneve dhe faktorëve të ndryshëm investues pritet të sjellë rezistencë të konsiderueshme ndaj 'luftës së tarifave' e cila mund të zgjasë më shumë sesa pritjet fillestare të pjesëmarrësve në treg. Kthimi për vitin aktualisht është -7.1%, ndërsa prej themelimit është +69.0%. Është e rëndësishme të theksohet se rëniet aktuale njihen si humbje të porealizuara, pra janë subjekt i evoluimit të tregut dhe nuk përbëjnë humbje të vërteta për kontribuuesit. Strategjia e FKPK-së për investime të diversifikuara dhe afatgjata mbetet e njëjtë: të sigurojë rritje të qëndrueshme dhe stabilitet për të gjithë kontribuuesit, dhe mbrojtje maksimale për kontribuuesit afër pensionimit.
PËRFAQËSUES TË FKPK-SË TAKOHEN ME GUVERNATORI N E BQK-SË	7 mars 2025 - Kryesuesit i Bordit Drejtues të FKPK-së, z. Emanuel Bajra, i shoqëruar nga anëtarë të Bordit Drejtues dhe Drejtori Menaxhues, u pritën në takim nga Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, z. Ahmet Ismaili, i shoqëruar nga Zëvendësguvernatori për Mbikëqyrje Financiare dhe bashkëpunëtorët e tij. Z. Bajra e njoftoi Guvernatorin me situatën aktuale në FKPK, plotësimin e Bordit Drejtues me të gjithë anëtarët, por edhe nevojën për të analizuar ndryshimet legjislative dhe të qeverisjes për t'u përshtatur më mirë me zhvillimet e kohës. Po ashtu, ai informoi për pikëpamjet e FKPK-së me gjendjen aktuale në tregjet financiare globale, pritshmëritë e mundshme por edhe strategjinë që FKPK-ja është duke e ndjekur në fushën e investimeve, për të siguruar qëndrueshmërinë e investimeve sipas objektivave ligjore. Nga ana tjetër, Guvernatori Ismaili i informoi drejtuesit e FKPK-së lidhur me zhvillimet kryesore në sektorin financiar, reformat e ndërmarra nga BQK-ja në avancimin e kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse, duke nënvizuar stabilitetin dhe performancën e mirë të sektorit financiar, si dhe nismat ligjore për gjithëpërfshirjen financiare, qasjen në financa dhe edukimin financiar. Ai shtroi nevojën për qasje të kujdesshme dhe vendimmarrje efektive në kohe të turbulencave të ndryshme globale dhe gjeopolitike.

E PUBLIKON:

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës
Prill 2025

E PËRGATIT:

Njësia për Marrëdhënie me Publik

Adresa:

Rr. "Agim Ramadani" #182-184 10000 Prishtinë, Kosovë

E-MAIL & UEB:

info@trusti.org | www.trusti.org

FACEBOOK

TrustiPensional

LINKEDIN

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës

YOUTUBE

Fondi Pensional i Kosovës